

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i  
Avancuar

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 21.11.2020

1. Elsa sh.a, është një kompani me përgjegjësi të kufizuar e listuar në bursë cila operon në sektorin e shërbimeve në Kosovë. Elsa sh.a ka marrëdhënie biznesi me dy kompani të tjera kosovare, Anna sh.a dhe Olaf sh.a, të cilat janë gjithashtu shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Draft pasqyrat e pozitës financiare të këtyre tri kompanive janë më poshtë në 31 dhjetor 2019

	Elsa sh.a €'milion	Anna sh.a €'milion	Olaf sh.a €'milion
<b>Pasuritë</b>			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet	460.0	150.0	155.0
Investimet në filiala			
Anna sh.a	365.0		
Olaf sh.a		160.0	
Investimet në Iduna sh.a	24.0		
Pasuritë e patrupëzuara	<u>99.0</u>	<u>15.0</u>	<u>17.5</u>
	948.0	325.0	172.5
Pasuritë qarkulluese	<u>447.5</u>	<u>240.0</u>	<u>125.0</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,395.5</b>	<b>565.0</b>	<b>297.5</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
Aksionet e zakonshme	460.0	200.0	100.0
Komponentë të tjerë të ekuitetit	36.5	18.5	12.5
Fitimet e mbajtura	<u>447.5</u>	<u>221.0</u>	<u>69.5</u>
Total ekuiteti	944.0	439.5	182.0
Detyrimet afatgjata	247.5	61.5	46.5
Detyrimet afatshkurtëra	<u>204.0</u>	<u>64.0</u>	<u>69.0</u>
Total detyrimet	<u>451.5</u>	<u>125.5</u>	<u>115.5</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,395.5	565.0	297.5

#### **Informata shtesë të rëndësishme:**

- i) Elsa sh.a, on 1 janar 2018, bleu 60% të interesave të ekuitetit të Anna sh.a. Kostoja e investimit ishte në para prej €360 milion. Gjatë blerjes, vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Anna sh.a u vlerësua në €146 milion. Në datën e blerjes, vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të blera arriti në €417.5 milion dhe fitimet e mbajtura të Anna sh.a u vlerësuan të ishin €159.5 milion, ndërsa përbërësit e tjerë të ekuitetit ishin €13.5 milion. Teprica mbi vlerën e drejtë rezulton nga një tokë e pa zhvlerësueshme.
- ii) Anna sh.a më 1 janar 2019, bleu 70% të interesave të ekuitetit të Olaf sh.a për një shumë parash prej €160 milion. Vlera e drejtë e pronësisë prej 30% të interesit jo-kontrollues u vlerësua në €36 milion, dhe pronësia prej 58% ishte €80.5 milion. Në datën e blerjes, pasuritë neto të identifikueshme të Olaf sh.a kishin një vlerë të drejtë prej €181 milion, fitimet e mbajtura ishin €53 milion dhe përbërësit e tjerë të ekuiteit ishin €10 milion. Teprica mbi vlerën e drejtë është për shkak të tokës jo të zhvlerësueshme. Është politikë e grupit për të matur interesin jo-kontrollues me vlerën e drejtë në datën e blerjes.

- iii) Me 1 janar 2018, Elsa sh.a bleu 14% të interesave të ekuitetit në Iduna sh.a, për një shumë parash prej €9 milion. Investimi u llogarit sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare* dhe u përcaktua si me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Më 1 korrik 2019, Elsa sh.a fitoi një interes shtesë prej 16% në Iduna sh.a për një shumë parash prej €13.5 milion dhe arriti një ndikim ndomëthënës. Vlera e investimit fillestar prej 14% me 1 korrik 2019 ishte €10.5 milion. Iduna sh.a realizoi fitime pas tatimit prej €10 milion dhe €15 milion përkatësisht për vitet 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2019. Më 31 dhjetor 2019, Elsa sh.a mori një dividendë nga Iduna sh.a në vlerë prej €1 milion, e cila u është kredituar përbërësve të tjerë të ekuitetit.
- iv) Elsa sh.a bleu patentat në vlerë prej €5 milion për t'u përdorur në një projekt për zhvillimin e produkteve të reja më 1 janar 2019. Elsa sh.a ka përfunduar fazën e hulumtimit të projektit, duke bërë një kosto shtesë prej €3.5 milion dhe tani ka përcaktuar se produkti mund të zhvillohen me fitim. Një prototip efektiv dhe funksional u krijua me një kosto prej €2 milion dhe për të vendosur produktin në një gjendje për shitje, u shpenzuan edhe €1.5 milion. Më në fund, u bënë kosto të marketingut prej €1 milion. Të gjitha kostot e mësipërme janë përfshirë në pasuritë e patrupëzuara të Elsa sh.a-së.
- v) Testet e dëmtimi u kryen si për Anna sh.a ashtu edhe për Olaf sh.a më 31 dhjetor 2019. Shumat e rikuperueshme të të dy njësive gjeneruese të mjeteve monetare siç u deklaruan në pasqyrat financiare individuale më 31 dhjetor 2019 ishin Anna sh.a, €712.5 milion dhe Olaf sh.a, €302 milion përkatësisht. Drejtorët e Elsa sh.a menduan se çdo dëmtim i pasurive ishte për shkak të performancës së dobët të pasurive të patrupëzuara dhe u gjykua se pasuritë e tjera ishin mbajtur tashmë në shumën e rikuperueshme. Shumat e rikuperueshme janë përcaktuar pa i marrë në konsideratë detyrimet të cilat kanë të bëjnë me financimin e operacioneve.

**Kërkohet:**

**Përgatite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare për grupin Elsa sh.a me 31 dhjetor 2019. (20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 1

### Grupi Elsa sh.a

#### Pasqyra e konsoliduar të pozitës financiare 31 dhjetor 2019

Pasuritë:	€milion
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet (460 + 150 + 155 +44.5 + 18)	827.5
Zëri i mirë (L13)	93.5
Pasuritë e patrupëzuara (99 + 15 + 17.5 - 4.5 -13.5)	113.5
Investimet në Iduna sh.a (L17)	25.25
Pasuritë qarkulluese (447.5 + 240 + 125)	<u>812.5</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,872.25</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
Ekuiteti i atribuar pronarëve të prindit	
Akzionet e zakonshme	460
Fitimet e mbajtura (L15)	489.41
Komponentë të tjerë të ekuitetit (L15)	<u>38.05</u>
	987.46
Interesi jo-kontrollues (L14)	<u>192.29</u>
	1,179.75
Total detyrimet afatgjata (247.5 + 61.5 + 46.5)	355.5
Detyrimet afatshkurtëra (204 + 64 + 69)	337.0
Total detyrimet	<u>692.5</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,872.25

### Llogaritjet

#### (L11) Struktura e grupit

Elsa në Iduna sh.a (14% deri 1 korrik 2019, 30% nga 1 korrik 2019)

Elsa në Anna sh.a 60%

Anna sh.a në Olaf sh.a 70%

Pronësia efektive e grupit në in Olaf sh.a është 42% (60% x 70%).

Andaj IJK është 58% (100% - 42%).

	Anna sh.a	Olaf sh.a
Elsa sh.a (grupi) pronësia: direkte	60%	-
Indirekte - 60% x 70% =		42%
IJK: direkte	40% (100% - 70%) =	30%
Indirekte - 40% x 70% =		<u>28%</u>
	100%	100%

**(L12)****Neto pasuritë - Anna sh.a**

	<b>Data e blerjes</b>	<b>Data e raportimit</b>	<b>Ndryshimi</b>
	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>
Kapitali aksionar	200	200	-
Komponentët tjerë	13.5	18.5	5.0
Fitimet e mbajtura	159.5	221	61.5
Korigjimet vlerës së drejtë- toka	<u>44.5</u>	<u>44.5</u>	<u>-</u>
	<b>417.5</b>	<b>484</b>	<b>66.5</b>

**Neto pasuritë - Olaf sh.a**

	<b>Data e blerjes</b>	<b>Data e raportimit</b>	<b>Ndryshimi</b>
	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>
Kapitali aksionar	100	100	-
Komponentët tjerë	10	12.5	2.5
Fitimet e mbajtura	53	69.5	16.5
Korigjimet vlerës së drejtë- toka	<u>18</u>	<u>18</u>	<u>-</u>
	<b>181</b>	<b>200</b>	<b>19</b>

**(L13) Zëri i mirë****Anna sh.a**

	<b>€ milion</b>
Vlera e drejtë e konsideratës	365
Vlera e drejtë e IJK-së	146
Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të blera (L12)	<u>(417.5)</u>
Zëri i mirë në blerje	93.5

**Olaf sh.a**

	<b>€ milion</b>
Vlera e drejtë e konsideratës	160
Korigjimi i pronësisë indirekte (40% x €160)	(64)
VD e IJK-së në blerje (58% pronësi)	80.5
Minus vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme (L12):	<u>(181)</u>
Zëri i mirë negativ në blerje	(4.5)
Zëri i mirë tek fitimi ose humbja	<u>4.5</u>
Zëri i mirë në datën e raportimi	-

**(L14) Interesi jo-kontrollues**

	<b>€ million</b>
IJK në Anna sh.a në blerje	146
IJK% e fitimeve pas blerjes (40% x (€484 - €417.5) (L12))	26.6
Korigjimi i pronësisë indirekte (40% x €160)	(64)
IJK në Olaf sh.a në blerje	80.5
IJK% e fitimeve pas blerjes (58% x (€200 - €181) (L12))	11.02
Dëmtimi (58% x €13.5 (L16))	<u>(7.83)</u>
	192.29

## **(L15) Rezervat**

<b>Fitimet e mbajtura</b>	<b>€ milion</b>
Elsa sh.a	447.5
Anna sh.a: 60% x (€221 - €159.5 (L12))	36.9
Olaf sh.a: 42% (€69.5 - €53) (L12))	6.93
Dëmtimi (42% x €13.5 (L16))	(5.67)
Iduna sh.a përfitimi nga TTGJ (L17)	1.5
Iduna sh.a dividenda (L17)	1
Pejsa e fitimeve pas blerjes së Iduna sh.a-së (L17)	1.25
Teprica kapitale (Zëri i mirë negativ i Olaf sh.a)	4.5
Pasuritë e patrupëzuara (L18)	<u>(4.5)</u>
	<b>489.41</b>

<b>Komponentë të tjerë të ekuitetit</b>	<b>€ milion</b>
Elsa sh.a	36.5
Anna sh.a: 60% x (€18.5 - €13.5) (L12)	3
Olaf sh.a: 42% (€12.5 - €10) (L17))	1.05
Iduna sh.a përfitimi tek fitimet e mbajtura (L17)	(1.5)
Iduna sh.a dividenda (L17)	<u>(1)</u>
	<b>38.05</b>

## **(L16) Dëmtimi**

Në shënimin 6 të pyetjes, na është thënë që shuma e rikuperueshme e secilit filial është përcaktuar 'pa marrë në konsideratë detyrimet'. Me fjalë të tjera, janë dhënë vetëm shumatat e rikuperueshme të pasurive. Sigurohuni që ta krahasoni këtë vetëm me shumatat e rikuperueshme të asetëve. Sigurohuni që ta krahasoni këtë me vlerën e mbartur të pasurive të secilës filialë (në vend të pasurive neto).

	<b>Anna sh.a</b>	<b>Olaf sh.a</b>
	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>
Zëri i mirë (L13)	93.5	-
Pasuritë (sipas PPF)	565	297.5
Korigjimi i vlerës së drejtë (L12)	<u>44.5</u>	<u>18</u>
Vlera e total pasurive	704.5	315.5
Shuma e rikuperueshme	<u>(712.5)</u>	<u>(302)</u>
Dëmtimi	n/a	13.5

Nuk ka asnjë dëmtim në rastin e Anna sh.a por pasuritë e Olaf sh.a-së janë dëmtuar. Rezervat e grupit do të debitohen me €5.67 milion dhe IJK me €7.83 milion, duke qenë humbja në vlerë e pasurive të ndara sipas interesave efektivë.

## **(L17) Iduna sh.a**

Elsa sh.a ka influencë domëthënëse mbi Iduna sh.a. Prandaj Iduna sh.a është një ortakëri dhe duhet të kontabilizohet duke përdorur metodën e ekuitetit. Fitimi prej 1.5 milion € (10.5 milion € - 9 milion €) regjistruar me TTGJ deri në 1 korrik 2019 nuk do të transferohet në fitim ose

humbje për vitin, por mund të transferohet brenda ekuitritit dhe si rrjedhojë te fitimet e mbajtura sipas SNRF 9 *Instrumentet financiare*.

D TTGJ €1.5 milion  
K Fitimet e mbajtura €1.5 milion

Dividenda duhet t'i ishte kredituar fitimit ose humbjes të Elsa sh.a. dhe jo TTGJ.

D TTGJ €1 milion  
K Fitimet e mbajtura €1 milion

Shuma e përfshirë në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare do të ishte:

	<b>€ milion</b>
Kosto(€10.5 milion + €13.5 milion)	24
Pjesa e fitimeve pas blerjes (€15 milion x 6/12 x 30%)	2.25
Minus dividenda e pranuar	<u>(1.0)</u>
	25.25

Nuk ka asnjë dëmtim pasi vlera bartëse e investimit në pasqyrat financiare të veçanta nuk e kalon vlerën bartëse në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe as dividenda nuk tejkalon të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të ortakërisë në periudhën në të cilën deklarohet dividenda.

Pjesa e grupit e lëvizjve në fitimet e mbajtura pas blerjes është €1.25 milion (€2.25 milion - €1.0 milion). Kjo do të mbahet brenda fitimeve në grup (L15).

#### **(L18) Zhvillimi**

Ekzistojnë kritere të rrepta në SNK 38 që rregullon zërat që mund të përfshihen në koston e një pasurie të patrupëzuar. Elsa sh.a duhet të njohë €5 milion si një pasuri të patrupëzuar plus koston e prototipit prej €2 milion dhe €1.5 milion për ta sjellë atë në gjendje për shitje. Pjesa e mbetur e kostove duhet të shpenzohen duke përfshirë kostot e marketingut. Kjo arrin në €4.5 milion, të cilat duhet të merren nga pasuritë e patrupëzuara dhe të shpenzohen.

D Fitimet e mbajtura € 4.5 million  
K Pasuritë e patrupëzuara €4.5 million

## 2.

a) Baloo sh.a ka kryer transaksione të caktuara në valutë të huaj gjatë vitit financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019 dhe gjithashtu ka kryer operacione të huaja përmes një entiteti të huaj. Valuta funksionale dhe prezantuese e Baloo sh.a. është euro.

Me 30 shtator 2019 Baloo sh.a bleu mallra nga një furnizues i huaj për \$16 milion dollarë amerikanë. Me 31 dhjetor 2019, furnizuesi nuk ishte paguar ende dhe mallrat ende mbaheshin në stoqe nga Baloo sh.a.

Më 30 shtator 2019 Baloo Ltd i shiti mallra një klienti të huaj për \$48 milion dollarë dhe arkëtoi pagesën në dollarë më 31 dhjetor 2019. Baloo sh.a gjithashtu kishte blerë një investim në pasuri të patundshme në 1 janar 2019 për \$56 milion dollarë amerikanë. Me 31 dhjetor 2019, investimi në pasuri të patundshme kishte një vlerë të drejtë prej \$48 milion dollarë amerikanë. Kompania përdor modelin e vlerës së drejtë në kontabilitetin për investimet në pasuri të patundshme.

Baloo sh.a dëshiron këshillë se si t'i trajtojmë këto transaksione në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019.

	<b>Kursi i këmbimit (kuota direkte) €1</b>	<b>Mesatarja për vitin</b>
1 janar 2018	€0.9091/1 dollarë amerikan	
31 dhjetor 2018	€0.7143/1 dollarë amerikan	€0.8333/1 dollarë amerikan
1 janar 2019	€0.7143/1 dollarë amerikan	
30 shtator 2019	€0.6250/1 dollarë amerikan	
31 dhjetor 2019	€0.7692/1 dollarë amerikan	€0.6667/ 1 dollarë amerikan

### **Kërkohet:**

**Diskuto trajtimin në kontabilitet për transaksionin mësipër në pajtim me këshillën e kërkuar nga drejtorët. (10 pikë)**

**(Ju duhet të tregoni llogaritjet në detaje si dhe diskutimin e trajtimit të përdorur në kontabilitet.)**

b) Pluto sh.a përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) me fundin e vitit financiar 31 dhjetor 2019. Me 1 janar 2019, Pluto sh.a filloi një plan pensioni me përfitime të përcaktuara për një numër të punonjësve të zyrës qendrore. Sipas skemës së pensioneve, Pluto sh.a ka një detyrim t'u sigurojë stafit përfitime të rëna dakord pas punësimit. Pluto sh.a mbart rrezikun aktuarial dhe të investimeve që lidhen me skemën e pensioneve.

Informacioni i mëposhtëm është përpiluar nga llogaritjet e stafit të kontabilitetit të Pluto sh.a dhe raportet aktuariale për vitin financiar 2019;

	<b>€</b>
Të hyrat nga interesi në pasuritë e planit	16,500
Kontributet e punonjësve në plan	550,000
Kosto e shërbimit aktual	600,000
Interesi në detyrimet e planit	18,000
Vlera e drejtë e pasurive të planit me 31 dhjetor 2019	580,000
Vlera e tanishme e obligimeve të planit me 31 dhjetor 2019	620,000



Kontabilisti nuk ishte i sigurt se cilin standard të kontabilitetit të zbatonte kur bënte llogari për skemën e pensioneve. Rregullimi i vetëm që u bë për të llogaritur skemën ishte shpenzimi i kontributeve të kompanisë prej €550,000 për vitin financiar 2019 në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe Të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse dhe kreditimi i llogarisë 'Paraja'

**Kërkohet:**

**Rekomando, me llogaritje trajtimin e duhur në kontabilitet për këtë çështje. (10 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

2.

a) Stoqet, shitja e mallrave dhe investimet në pasuri të patundshme.

### Stoqet dhe të pagueshmet

Stoqet dhe të pagueshmet tregtare do të regjistrohen fillimisht me €10 milion (\$16 milion dollar amerikan x €0.6250).

Në fund të vitit më 31 dhjetor 2019, shuma e pagueshme është akoma e papaguar. Duhet të përkthehet në kursin e mbylljes në €12,3 milion (\$16 milion dollarë x €0.7692).

Kjo krijon një humbje të këmbimit prej €2.3 milion (12.3 - 10) e cila duhet të njihet në fitim ose humbje.

Nëse nuk është dëmtuar, stoqet (një pasuri jo-monetare) duhet të regjistrohen në €10 milion në fund të vitit.

### Shitja e mallrave

Shitja e mallrave duhet të regjistrohet në €5 milion (\$8 milion x 0.6250 €) milion si e hyrë si një e arkëtueshme tregtare.

Pagesa në dinarë u mor më 31 tetor 2019 dhe vlera aktuale e dollarëve të marrë ishte €6.2 milion (\$8 milion dollarë x 0.7692 €). Kjo krijon një fitim në këmbim prej €1.2 milion (6.2 - 5) i cili duhet të njihet në fitim ose humbje.

### Investimet në pasuri të patundshme

Investimet në pasuri të patundshme duhet të njihet në 1 janar 2019 me €40 milion (\$56 milion dollarë x €0,7143). Në fund të vitit, më 31 dhjetor 2019, prona duhet të njihet në vlerën e saj të drejtë prej €36.9 milion (\$48 milion dollarë x €0,7692). Rënia e vlerës së drejtë (40 - 36.9 = 3.1) duhet të njihet në fitim dhe humbje si humbje në pasuritë afatgjata. Prona është një pasuri jo-monetare dhe kur fitimi ose humbja nga një zë jo-monetar njihet në fitim ose humbje edhe elementi i fitimit ose humbjes në lidhje me kurset e këmbimit njihet gjithashtu në fitim ose humbje.

b)

Standardi i zbatueshëm i kontabilitetit është SNK 19 (Përfitimet e Punonjësve). Plani i pensionit të Pluto sh.a është një plan i përcaktuar i përfitimeve pasi Pluto sh.a ka një detyrim të sigurojë përfitime të rëna dakord pas punësimit dhe njësisia ekonomike mbart rrezikun aktuarial dhe të investimit të lidhur me skemën e pensionit.

Kontabilisti ka kontabilizuar kontributet e punëdhënësit në skemë gabimisht duke njohur thjesht kontributet e punëdhënësit në fitim ose humbje. SNK 19 kërkon që një detyrim (pasuri) i përfitimit të përcaktuar të njihet në pasqyrën e pozitës financiare në shumën e re të vlerës aktuale të detyrimit minus vlerën e drejtë të pasurive të skemës në datën e raportimit.

Një plan i përfitimit të përcaktuar mund të shkaktojë kosto aktuale të shërbimit dhe shpenzimin neto të interesit, të cilat duhet të njihen përmes fitimit ose humbjes. Për më tepër, çdo fitim dhe / ose humbje nga vlerësimi i ekspertëve nga ri-matja e detyrimit (pasurisë) të përcaktuar të pensionit duhet të njihet përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

**Llogaritjet - Fitimi/humbja nga vlerësimi i ekspertëve:**

€

Pasuritë e planit	
Saldo ne fillim	-
Kthimi në pasuri	16,500
Kontributet e punonjësve	550,000
Rimatja -Fitimi nga vlerësimi i ekspertëve	<u>13,500</u>
Saldo në fund	580,000

Detyrimet e pensionit	
Saldo ne fillim	-
Kosto e interesit	18,000
Kosto e shërbimit aktual	600,000
Rimatja - Humbja nga vlerësimi i ekspertëve	<u>2,000</u>
Saldo në fund	620,000

Neto Fitimi nga vlerësimi i ekspertëve: €13,500 - €2,000 = €11,500

Hyrjet në ditar:

D Neto shpenzimet e interesit (P+L)	1,500	
K Detyrimet e pensionit		1,500
<i>Neto shpenzimet e interesit (18,000 - 16,500)</i>		
D Kosto e shërbimit aktual (P+L)	600,000	
K Detyrimet e pensionit		600,000
<i>Kosto e shërbimit aktual</i>		
D Neto detyrimet e pensionit	11,500	
K Rimatja - Fitimi nga vlerësimi i ekspertëve: (TTGJ)		11,500
<i>Njohja e Neto humbjes nga vlerësimi i ekspertëve TTGJ. (13,500 - 2,000)</i>		

Së fundmi, trajtimi i mëparshëm i kontabilitetit të kontabilistit për kontributet e punëdhënësit duhet të korrigjohet:

D Neto Detyrimet e pensionit (PPF)	550,000	
K Shpenzimet e kontributit të pensioneve (F&H)		550,000

Kontributet e paguara në skemën e përfitimeve të përcaktuara - korrigjimi i kontabilitetit të mëparshëm duke trajtuar shpenzimet e kontributeve përmes F&H

3. Lilo sh.a është i përfshirë në biznesin e prodhimit të produkteve kozmetike dhe shëndetësore. Bilancet e mëposhtme janë nxjerrë nga librat e Lilo sh.a më 31 dhjetor 2019.

	<b>DEBI</b>	<b>KREDI</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
Të hyrat		39,375,500
Të ardhurat nga investimet		250,000
Kosto e shitjes	16,783,000	
Shpenzimet administrative	4,032,000	
Shpenzimet e shpërndarjes	1,221,750	
Shpenzimet e interesit	562,500	
Tatimi i paguar	430,000	
Toka sipas vlerësimit me 1 janar 2019	27,440,000	
Ndërtesa sipas vlerësimit me 1 janar 2019	16,200,000	
Fabrika dhe paisja sipas koston me 1 janar 2019	8,055,000	
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2019:		
- Ndërtesa		1,296,000
- Fabrika dhe paisja		4,207,500
Investimet në pasuri të patundshme	16,010,000	
Investimet	4,240,000	
Pasuritë e patrupëzuara	801,000	
Stoqet me 31 dhjetor 2019	2,587,500	
Të arketueshmet tregtare dhe të tjera	4,871,000	
Banka	3,375,000	
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		4,746,000
Detyrimi i tatimit të shtyrë		191,250
Kredi nga banka		6,000,000
Rezerves së rivlerësimit:		
- Toka		6,072,000
- Ndërtesa		3,000,500
Kapitali aksionar i zakonshëm (€1 pwr aksion)		30,720,000
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2019		<u>10,750,000</u>
	<b>106,608,750</b>	<b>106,608,750</b>

#### **Informata shtesë:**

i) Toka dhe ndërtesa rivlerësohen çdo tre vjet dhe gjendja në rezervën e rivlerësimit të lidhet me rivlerësimin e vitit paraardhës. Një rivlerësim i tokës dhe ndërtesës në 2 Janar 2019 ka rezultuar në një rënie përkatësisht prej €5,000,000 dhe €2,500,000 dhe këto rivlerësime nuk janë regjistruar.

Kompania nuk bën një transfer vjetor nga rezerva e rivlerësimit në fitimet e mbajtura.

ii) Kompania kishte marrë një grant qeveritar prej €1,000,000 me 1 janar 2018 për të blerë një makineri speciale që kushtonte €2,500,000. Është politikë e kompanisë të regjistrojë grantin qeveritar duke përdorur metodën e të hyrave të shtyra. Sidoqoftë, shuma e grantit qeveritar të marrë ishte zbritur nga makineria vitin e kaluar.

Është politika e kompanisë që të zhvlerësojë ndërtesën e saj për 50 vjet në bazë drejtvizore. Impiantet e prodhimit dhe makineritë zhvlerësohen për 10 vjet bazuar në kohën e pronësisë. Shpenzimi i zhvlerësimit duhet të përfshihet si pjesë e shpenzimeve administrative.

- iii) Kompania miratoi modelin e vlerës së drejtë për investimet e saj në pasuri të patundshme. Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2019 ishte €17,500,000.
- iv) Investimi i mbajtur nga Lilo sh.a përfshin 2,000,000 aksione të zakonshëm në Pongo sh.a i cili matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Aksionet u blenë nga kompania gjatë vitit. Me 31 dhjetor 2019, vlera e drejtë e një aksioni të zakonshëm të Pongo sh.a ishte 2.90 €. Kjo vlerë ende nuk është reflektuar në pasqyrat financiare të Lilo sh.a.
- v) Gjatë azhurnimit të regjistrimit të pasurive, kompania zbuloi se data e blerjes për makineri të caktuara gjatë tre viteve të fundit ishte regjistruar gabimisht. Kjo ndikon në periudhën e pronësisë së makinerive. Si rezultat, zhvlerësimi i vitit të kaluar i makinerive ishte mbivlerësuar për €850,000.
- vi) Me 1 janar 2019, kontabilisti kuptoi se kostoja e zhvillimit prej €320,000 e shkaktuar në dhjetor 2018 ishte shpenzuar. Ai gjithashtu vuri në dukje se kostoja e zhvillimit do të sjellë përfitim të ardhshëm ekonomik për kompaninë dhe plotësoi kriteret për kapitalizim sipas SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara*.
- vii) Ngarkesa e tatimit në fitim për vitin është vlerësuar në €500,000 që përjashton ndryshimet në detyrimin e tatimit të shtyrë. Detyrimi i tatimit të shtyrë në 31 dhjetor 2019 u vlerësua në €212,500.

**Kërkohet:**

- a) **Përgatite pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019.**  
(Kërkohet llogaritja e fitimet për aksion). (8 pikë)
- b) **Përgatite pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2019.** (12 pikë)

### Zgjidhja e problemit 3

#### Lilo sh.a

#### Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

	€
Të hyrat	39,375,500
Kosto e shitjes	<u>(16,783,000)</u>
Fitimi bruto	22,592,500
Të ardhurat nga investimet	250,000
Amortizimi i të hyrave të shtyera 1,000 /10	100,000
Përfitimi në vlerën e drejtë të IPP (17,500 - 16,010)	1,490,000
Përfitimi në vlerën e drejtë të investimit 5,800 - 4,240	1,560,000
Shpenzimet administrative 4,032,000 + 1,179,500	(5,211,500)
Shpenzimet e shpërndarjes	(1,221,750)
Shpenzimet e interesit	<u>(562,500)</u>
Neto fitimi para tatimit	18,996,750
Tatimi 500,000 +21,250	<u>(521,250)</u>
<b>Neto fitimi pas tatimit</b>	<b>18,475,500</b>

#### Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:

Rënia në rivlerësim - toka	(5,000,000)
Rënia në rivlerësim - ndërtesa	<u>(2,500,000)</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	<b>10,975,500</b>

Fitimi për aksion 18,475,500/30,720,000 €0.60

#### Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019

##### Pasuritë jo-qarkulluese

	€
Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet	39,262,000
Investimet në pasuri të patundshme	17,500,000
Pasuritë e patrupëzuara 801 + 320	1,121,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	2,587,500
Të arketueshmet tregtare dhe të tjera	4,871,000
Banka	3,375,000
Investimet nepermjet fitimit ose humbjes	<u>5,800,000</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>74,516,500</b>

##### Ekuiteti

Kapitali aksionar L1	30,720,000
Fitimet e mbajtura L2	30,395,500
Rezervat tjera	1,572,500
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Kredi nga banka	6,000,000
Detyrimi i tatimit të shtyrë	212,500
Të hyrat e shtyera 1,000,000 - 200,000	800,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	4,746,000

Tatimi i pagueshëm 500 – 430	<u>70,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>74,516,500</b>

### L11 Fitimet e mbajtura

	€
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2019	10,750,000
Korigjimet e vitit paraprak:	
Zhvlerësimi i nënvlerësuar	(100,000)
Zhvlerësimi i mbivlerësuar	850,000
Amortizimi i të hyrave të shtyera	100,000
Kosto e zhvillimit e kapitalizuar	320,000
Saldo e rideklaruar	11,920,000
Fitimi për vitin	<u>18,475,500</u>
Fitimet e mbajtura me 31 dhjetor 2019	30,395,500

### L12 Rezervat tjera

	€
Rezerves e rivlerësimit	
Toka: 6,072,000 – 5,000,000	1,072,000
Ndërtesa: 3,000,500 – 2,500,000	<u>500,500</u>
	1,572,500

### Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet

	Toka €	Ndërtesa €	Fabrika & paisjet €	Total €
<u>Kosto/Vlerësimi</u>				
Saldo në fillim	27,440,000	16,200,000	8,055,000	51,695,000
Korigjimet e vitit paraprak:				
Granti qeveritar			1,000,000	1,000,000
Saldo e rideklaruar	27,440,000	16,200,000	9,055,000	52,695,000
Deficit në rivlerësim	(5,000,000)	(2,500,000)		(7,500,000)
Saldo në fund	22,440,000	13,700,000	9,055,000	45,195,000
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>				
Saldo në fillim	-	1,296,000	4,207,500	5,503,500
Korigjimet e vitit paraprak:				
Zhvlerësimi i nënvlerësuar			100,000	100,000
Zhvlerësimi i mbivlerësuar			(850,000)	(850,000)
Saldo e rideklaruar	-	1,296,000	3,457,500	4,753,500
Ngarkesa për vitin	-	274,000	905,500	1,179,500
Saldo në fund	-	1,570,000	4,363,000	5,933,000
<b>Vlera bartëse</b>	<b>22,440,000</b>	<b>12,130,000</b>	<b>4,692,000</b>	<b>39,262,000</b>

4.

a) Relativizmi është një këndvështrim së një mori e gjerë e besimeve dhe praktikave të pranueshme etike ekzistojnë. Etika që është më e përshtatshme në një situatë të caktuar do të varet nga rrethanat në atë kohë. Qasja relativiste propozon që të gjitha deklaratat morale janë para se gjithash subjektive dhe rrjedhin nga forma e kulturës, besimit apo emocionit të folësit.

**Kërkohet:**

**Shpjego përparësitë dhe mangësitë e relativizmit. (10 pikë)**

b) Transaksionet në të cilat entiteti përfton (blen) mallra ose shërbime nga palët e tjera, të tillë si furnitorët dhe punonjësit dhe për të cilat jep si kompensim instrumentet e ekuitetit të entitetit, dhe kjo nëpërmjet emetimit të aksioneve ose dhënies së kontratave me mundësi zgjedhjeje për aksione ndaj palëve të tjera, janë përherë e më të zakonshme.

SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione* kërkon që entitetet të pasqyrojnë efektet e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione në pasqyrën e të fitimit ose humbjes dhe në pozitën të vet financiare [pasqyrën e pozitës financiare].

**Kërkohet:**

**Shpjego tri llojet e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione. (5 pikë)**

c) Remy sh.a shet produktet e veta duke dhënë garanci për kostot e riparimeve për të gjitha defektet e prodhimit të cilat dalin në pah gjatë vitit të parë pas blerjes. Eksperiencat e kaluara të kompanisë tregojnë karakteristikat e mëposhtme të riparimeve të mundshme.

**Kostoja e riparimit**

<b>% e mallrave të shitur</b>	<b>Defekti</b>	<b>€milion</b>
50	Pa defekt	-
40	I vogël	6.0
10	I madh	10.0

**Kërkohet:**

**Llogarite shumën e provizionit që duhet të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në pasqyrën e pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. (5 pikë)**



## Zgjidhja e problemit 4

a)

### Përparësitë e relativizmit

- Relativizmi nxjerr në pah paragjykimet tona të njohjes në vështrimin e ndjenjave tona (ne shohim vetëm atë çfarë dimë dhe e kuptojmë) dhe paragjykimet tona të paramenduara (atë çfarë ne e masim pa përdorur shqisat tona është subjekt i paragjyqimeve të medotave të përdorura).
- Relativizmi gjithashtu nxjerr në pah dallimet në besimet kulturore; për shembull të gjitha kulturat mund të thonë që është e padrejtë vrasja e të pafajshëmve, por kulturat mund të kenë besime të ndryshme se kush më të vertetë janë të pafajshëm.
- Filozofi Bernard Crick ka pohuar se besime të ndryshme absolutiste rezultojnë në konflikt moral ndërmjet njerëzve; (relativiste) etika duhet të veprojë që të zgjedh konflikte të tilla.
- Në ekonominë globale, ku kompanitë kryejnë biznes në shumë vende dhe kultura, duke adoptuar një qasje relativiste lejon më shumë fleksibilitet, andaj edhe më shumë sukses.

### Kritikat e relativizmit

- Thënë thjesht, relativizmi i fortë bazohet në një kontraditë fundamentale; deklaratën që "Të gjitha deklaratat janë relative" në vetvete është absolute. Megjithatë është e mundshme që të argumentohet se disa të verteta universale (disa ligje të fizikës) ekzistojnë, por mohojnë të verteta tjera që supozohen të jenë objektive.
- Një kritikë e shpeshtë e relativizmit, e veqanërisht nga liderë religjioz, është që shpie në një filozofi të 'gjithqka pranohet' duke mohuar ekzistencën e moralit dhe lejuar aktivitete që janë të dëmshme për të tjerët.
- Në mënyrë alternative disa kritikë kanë argumentuar ekzistencën e ligjeve natyrore të moralit. Këto nuk janë domosdoshmërisht ligje religjioze; shkencëtari ateisti Richard Dawkins kanë dhënë argumente në favor të ligjeve natyrore.
- Ide të tilla si objektiviteti dhe e vërteta e fundit kanë vlerë – merrni në konsideratë për shembull parimin etik që kontabilistët duhet të jenë objektiv.
- Nëse vlenë të thuhet që opinionet e ndryshme të të gjithëve janë të drejta, atëherë vlenë njëjtë të thuhet që opinionet e ndryshme të të gjithëve janë të gabuara.

b) SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione zbatohet për të gjitha transaksionet e pagesave të bazuara në aksione. Ka tre lloje transaksionesh.

- **Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet**, në të cilat entiteti përfton (merr) mallra ose shërbime dhe jep si kompensim

instrumentet e ekuitetit të entitetit (përfshirë këtu aksionet ose kontratat me mundësi zgjedhjeje për aksione (opcionet)).

- **Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me para të gatshme**, në të cilat entiteti përfton [merr] mallra ose shërbime duke krijuar detyrime ndaj furnitorëve të këtyre mallra ose shërbimeve për shuma 9vlera monetare<sup>0</sup> të cilat bazohen mbi çmimin (ose vlerën) e aksioneve të entitetit ose instrumenteve të tjera të ekuitetit të entitetit.
- **Transaksionet në të cilat entiteti përfton (merr) mallra ose shërbime dhe kushtet e marrëveshjes i japin ose entitetit, ose furnitorit të këtyre mallrave ose shërbimeve një mundësi zgjedhjeje për sa i takon shlyerjes së detyrimeve që vijnë prej këtij transaksioni: me para të gatshme (ose me pasuri të tjera).**

c) Shuma e provizionit gjendet duket përdorur vleren e pritshme

$(50\% \times €0) + (40\% \times €6 \text{ milion}) + (10\% \times €10 \text{ milion}) = €3.4 \text{ milion.}$

5. Lightning McQueen sh.a është një shitës me pakicë i pjesëve të paisjeve motorike. I shet pjesët e saj nëpërmjet pikave të shitjes me pakicë. Kompania është formuar para 10 viteve. Në vijim janë pasqyrat financiare të Lightning McQueen sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor:**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të hyrat	5,120	5,280
Kosto e shitjes	<u>(2,016)</u>	<u>(1,584)</u>
Fitimi bruto	3,104	3,696
Të ardhurat tjera	96	132
Kosto e shpërndarjes	(940)	(924)
Kosto administrative	(1,680)	(1,584)
Kosto financiare	<u>(300)</u>	<u>(171)</u>
Fitimi para tatimit	280	1,149
Tatimi	<u>(56)</u>	<u>(230)</u>
<b>Fitimi për periudhën</b>	<b>224</b>	<b>919</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:		
Përfitimi nga rivlerësimi/(humbja)	90	(30)
Neto përfitimet nga vlerësimet e ekspertëve/(humbja)	<u>63</u>	<u>(23)</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>377</b>	<b>866</b>

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor:**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet	4,130	2,853
Investimet në pasuri të patundshme	1,099	871
Pasuritë tjera të patrupëzuara	<u>605</u>	<u>554</u>
	5,834	4,278
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	198	264
Të arkëtueshmet tregtare	360	412
Paraja & ekuivalentët e parasë	<u>154</u>	<u>61</u>
	<u>712</u>	<u>737</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>6,546</b>	<b>5,015</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<i>Ekuiteti</i>		
Akzione të zakonshme €2 secila	768	554
Komponentë të tjerë të ekuitetit	562	34
Fitimet e mbajtura	<u>1,049</u>	<u>1,145</u>
Total ekuiteti	2,379	1,733

<i>Detyrimet</i>		
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Përfitimet e punonjësve	620	813
Tatimi i shtyrë	495	343
Kredi bankare e pasiguruar	<u>2,400</u>	<u>1,514</u>
	3,515	2,670
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregatre	312	354
Tatimi	40	87
Kosto financiare e pagueshme	<u>300</u>	<u>171</u>
	<u>652</u>	<u>612</u>
Total detyrimet	<u>4,167</u>	<u>3,282</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>6,546</b>	<b>5,015</b>

#### **Informata shtesë:**

- i) Lightning McQueen sh.a zvogëloi çmimin e shitjes të pjesëve rezervë për 20% efektive nga janari 2019. Vëllimi i shitjeve të pjesëve rezervë ishte 12,000 dhe 9,000 në 2019 dhe 2018 respektivisht.
- ii) Të ardhurat tjera kanë të bëjnë me të ardhurat nga qirja e pranuar nga investimet në pasuri të patundshme. Lightning McQueen sh.a humbi një klient të madh në qershor 2019 dhe nuk është zëvendësuar.
- iii) Me 1 tetor 2019, Lightning McQueen sh.a hapi dy (2) pika të reja të shitjes në Prishtinë. Këto ishin në ndërtesa të marrura me qira. Numri i pikave të shitjes ishte 8 dhe 10 në 2018 dhe 2019 respektivisht.
- iv) Lightning McQueen sh.a bleu (3) gjenerator në janar 2019 për përdorim kur të ndalet rryma. Në gjysmën e dytë të vitit koha e mungesës së rrymës u rrit nga 2 orë në 8 orë për çdo ditë.
- v) Lightning McQueen sh.a importon të gjitha pjesët e saj rezervë nga SHBA-ja. Norma mesatare e këmbimit në vitin 2019 ishte €13 për 1\$ krahasuar me €11 për 1\$ në vitin 2018.
- vi) Lightning McQueen sh.a përdor modelin e vlerës së drejtë për investimet në pasuri të patundshme dhe modelin e rivlerësimit për patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet. Nuk kishte shitje të investimeve në pasuri të patundshme dhe patundshmëritë ,impiantet e prodhimit dhe paisjet në vitin 2019 dhe vitin 2018.
- vii) Lightning McQueen sh.a pagoi dividenda totale prej €250,000 në vitin deri me 31 dhjetor 2019 dhe €350,000 në vitin deri me 31 dhjetor 2018.
- viii) Lightning McQueen sh.a ka emetuar aksione shtesë me 1 janar 2019.

**Kërkohe:**

**Shkruaj një raport për drejtorin që vlerëson pozitën dhe performancën e Lightning McQueen sh.a për vitin deri me 31 dhjetor 2019.**

**(Përgjigja e juaj duhet të përmbaj llogaritjet përkatëse).**

**(20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 5

Për: Drejtorin – Lightning McQueen sh.a

Nga: Kontabilisti

Data:

Tema: Vlerësimi i pozitës dhe performancës së Lightning McQueen sh.a

### *Hyrje*

Vlerësimi i pozitës dhe performancës së Lightning McQueen sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 bazohet në informacionin financiar dhe jo-financiar për dy vjet. Analiza e raportit e përdorur bazohet në llogaritjet dhe informacionin shtesë të dhënë në pyetje.

### *Vlerësimi i pozitës dhe performancës*

#### Fitim-prurja

Të ardhurat kanë rënë për 3% L11 përkundër rritjes së vëllimit të shitjeve nga 9,000 në 12,000 pjesë rezervë që përfaqësojnë 33% L11. Rënia e të ardhurave i atribuohet kryesisht zvogëlimit të çmimit të shitjes me 20%, e cila nuk u kthye nga rritja e vëllimit të shitjeve. Rritja e vëllimit të shitjeve tregoi efektet pozitive të uljes së çmimit të shitjes, mbështetur nga numri i rritur i pjesëve rezervë të shitura për pikat e shitjes me pakicë nga 1,125 L11 në 1,200 L11. Sidoqoftë, kjo mund t'i atribuohet dy (2) pikave të shitjes me pakicë të sapohapura. Prandaj ka nevojë për të vendosur kontributin e pikave të hapura rishtas në vëllimin e përgjithshëm të shitjeve për të vlerësuar ndikimin real të zvogëlimit të çmimit të shitjes

Marzha e fitimit bruto ra nga 70% në 61% L11. Në mënyrë të ngjashme, marzha e fitimit operativ ra nga 25% në 11% L11. Rënia e koeficientëve të përmendur është për shkak të 20% zvogëlimit të çmimit të shitjes dhe rritjes së kostos së pjesëve rezervë që vijnë nga zhvlerësimi i euros nga 11€ për 1\$ në 13€ për 1\$. Përveç kësaj, shpenzimet e shpërndarjes dhe administratës u rritën duke hapur dy (2) pikat e shitjes me pakicë dhe duke rritur orët e mungesës së rrymës nga 2 në 8, gjë që rriti sasinë e shpenzuar për karburant për të përdorur gjeneratorët.

Pikat e reja të shitjes rritën kostot e qirasë dhe pagës përveç kostove të përgjithshme. Raportet e përfitimit gjithashtu janë ndikuar negativisht nga një rënie e të ardhurave të tjera nga €132,000 në €96,000 shkaktuar nga humbja e një klienti kryesor. Për më tepër, rillogaritja e fitimit operativ neto, duke injoruar të ardhurat e tjera €96,000 në 2019 dhe €132,000 në 2018 dhe rritjen e vlerës së drejtë të investimeve në pasuri të patundshme prej €228,000 (€1,099,000 - €871,000), do të jepte €256,000 në 2019 dhe 1,188,000 € në 2018 Kjo do të ndryshonte marzhën e fitimit operativ neto në 5% dhe 23% në 2019 dhe 2018 respektivisht.

Kthimi i kapitalit të angazhuar ka treguar një trend të ngjashëm rënës. Ka rënë në mënyrë drastike nga 30% në 10% L11. Kjo i atribuohet investimit në patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet, përfitimit nga rivlerësimi i tyre, rritjes së vlerës së drejtë të investimeve në pasuri të patundshme dhe një rënies së profitabilitetit të kompanisë.

## Llogaritjet

	2019	2018
<b>L11 Koeficientët e fitim-prurjes</b>		
Përqindja e rritjes së të hyrave = Rritja në të hyrat / të hyrat e vitit të kaluar = $(5,120 - 5,280) / 5,280 = (160) / 5,280 =$	-3%	
Përqindja e rritjes në vëllimin e shitjeve = Ndryshimi në vëllimin e shitjeve / Vëllimi në vitin e kaluar = $(12,000 - 9,000) / 9,000 = 3,000 / 9,000 =$	33%	
Shitjet mesatare për pikë të shitjes = Total shitjet/ Numri i pikave të shitjes 5,120/ 10; 5,280/8	€512	€660
Vëllimi mesatar i shitjeve për pikë të shitjes = Total vëllimi i shitjeve / Numri i pikave të shitjes 12,000/10; 9 000/8; €1,200	€1,200	€1,125
Kthimi në kapitalin e angazhuar = FPIT/KA = $(280 + 300) / (6,546 - 652) / = 580 / 5,894$ $(1,149 + 171) / (5,015 - 612) = 1,320 / 4,403$	10%	30%
Marzha e fitimit operativ = FPIT/Të hyrat = = $(280+300) / 5,120; (1,149+171) / 5,280 =$	11%	25%
Marzha e fitimit bruto = FB/ Të hyrat = $3,104/5,120; 3,696/ 5,280$	61%	70%
Qarkullimi i pasuritë = Të hyrat/ Kapitali i angazhuar 5,120/ 5,894; 5,280/ 4,403	0.87	1.20
Total shpenzimet si përqindje e shitjeve= Shpenzimet / të hyrat 2,920 / 5,120; 2,679/ 5,280	57%	51%
<b>L12 Likuiditeti dhe koeficientët e kapitalit qarkullues</b>		
Koeficienti qarkullues = Pasuritë qarkulluese/detyrimet afatshkurtëra 712 / 652; 737/ 612	1.09	1.20
Koeficienti i shpejtë = (Pasuritë qarkulluese – stoqet) / detyrimet afatshkurtëra 514 / 652                      473 / 612	0.79	0.77
Ditët e stoqeve = stoqet / Kosto e shitjes x 365 ditë 198 / 2,016 x 365; 264 1,584 x 365	36 ditë	61 ditë
Periodha e arkëtimit = Të arkëtueshmet tregtare / Të hyrat x 365 ditë 360 / 5,120 x 365; 412 / 5,280 x 365	26 ditë	28 ditë
Periodha e pagesës = Të pagueshmet tregtare / Kosto e shitjes x 365 ditë 312 / 2,016 x 365; / 354 / 1,584 x 365	56 ditë	82 ditë
<b>L13 Koeficientët e leverazhit</b>		
Hyrja në borxh = Totali i mëparshëm i kapitalit / (Totali i mëparshëm i kapitalit + Ekuiteti) x 100%		

2,400 / 4,779 x 365; 1,514 / 3,247 x 365 50% 47%

Hyrja në borxh = Borxhi / ekuiteti x 100%  
2,400 / 2,379; 1,514/1,733; 101% 87%

Mbulimi i interesit = FPIT / interesi  
580 / 300; 1,320/171 1.93 7.72

Përqindja e rritjes në borxh = (Borxhi aktual -borxhi i vitit të kaluar) / borxhi i vitit të kaluar  
886 / 1,514 = 59%

Interesi ne kredinë shtesë = Interesi aktual-interesi i vitit të kaluar  
129/886 = 15%

#### **L14 Koeficientët e investimit të aksionarëve**

Fitimi për aksion =  
= Fitimet qe i atribuohen aksionarëve / numri mesatar i ponderuar i aksioneve  
224 / 384; 919 / 277 0.58 3.32

Mbulimi i dividendës = Fitimet qe i atribuohen aksionarëve / dividenda e paguar  
224/ 250; 919/ 350 0.90 2.63

Dividenda për aksion = Dividenda e paguar / numri i aksioneve  
250/ 384; 350 / 277 0.65 1.26

#### Likuiditeti dhe kapitali qarkullues

Koeficienti qarkullues ka rënë nga 1.20 në 1.09 L12. Koeficienti i shpejtë nga ana tjetër është rritur pak nga 0.77 në 0.79 L12. Ndryshimi në këta koeficientë është kryesisht për shkak të rënies së stokeve dhe të arkëtueshmeve tregtare dhe rritjes së interesit të pagueshëm. Më tej, periudha e mbledhjes së të arkëtueshmeve tregtare ra nga 28 ditë në 26 ditë L12. Periudha e pagesës të pagueshmeve tregtare të Lightning McQueen sh.a gjithashtu ra nga 82 ditë në 56 ditë L12.

Qarkullimi i stokeve ka rënë nga 61 ditë në 36 ditë L12. Kjo i atribuohet nivelit të rritur të aktivitetit të biznesit. Kjo sepse vëllimi i shitjeve u rrit nga 9,000 në 12,000. Për më tepër, shifra e stokeve gjithashtu u zvogëluar nga €264,000 në €198,000. Rënia e qarkullimit të stokeve i atribuohet gjithashtu rritjes së kostos së shitjeve.

#### Koeficientët e leverazhit

Niveli i leverazhit në terma relativë është rritur nga 47% në 50% (L13) siç mund të shihet nga Koeficientët e leverazhit të boxhit ndaj ekuitetit që ka rënë nga 87% në 101% (L13). Sidoqoftë, në terma absolutë borxhi është rritur nga €1,514,000 në €2,400,000 që përfaqëson 59% (L13). Kjo ka ndikuar në rënien e mbulimit të interesit nga 7.72 herë në 1.93 herë (L13). Kjo i atribuohet gjithashtu zvogëlimit të profitabilitetit të kompanisë.

Përndryshe, kredia shtesë prej €886,000 (L13) u mor me normë më të lartë të interesit prej 15% (L13) krahasuar me 11% (€171,000 / €1,514,000) në 2018. Kjo tregon një rritje në profilin e rrezikut të Lightning McQueen sh.a.

#### Koeficientët e investimit të aksionarëve



Fitimet e Lightning McQueen sh.a për aksion kanë rënë nga 3.32 € në 0.58 € (L14). Kjo është shkaktuar nga zvogëlimi i profitabilitetit të kompanisë dhe rritja e numrit të aksioneve të zakonshme. Dividenda për aksion ka rënë nga 1.26 € në 0.65 € (L14). Dividenda aktuale për aksion ende nuk është e qëndrueshme për shkak të profitabilitetit të përkeqësuar të kompanisë

### Konkluzion

Pozita dhe performanca e Lightning McQueen sh.a është përkeqësuar në mënyrë drastike. Profitabiliteti i kompanisë ka rënë pavarësisht rritjes së vëllimit të shitjeve ndërsa likuiditeti dhe menaxhimi i kapitalit qarkullues kanë treguar përmirësim. Kompania duhet të përmirësoj profitabilitetin e saj dhe të menaxhojë borxhin e saj në nivele të qëndrueshme.

Sidoqoftë, duket se Lightning McQueen sh.a e konsideron përkeqësimin e pozitës dhe performancës financiare afatshkurtër duke gjykuar nga investimi material në patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet.